



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 90, Datë 13.05.2024

MBI

**NJOHJEN E LICENCËS PËR TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, LËSHUAR
NGA ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI E REPUBLIKËS SË KOSOVËS, PËR
SUBJEKTIN “MFT ENERGY KOSOVO L.L.C”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 97, pika 6 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 4 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.05.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 610/7 prot., datë 07.05.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës, për subjektin “MFT ENERGY KOSOVO L.L.C”,

Konstatoi se:

- Subjekti “MFT ENERGY KOSOVO”, degë e shoqërisë së huaj, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 610/4 prot., datë 23.04.2024, ka paraqitur kërkesën për njohje të licencës për tregtimin e energjisë elektrike, me numër ZRRE/Li_86/22, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji në Republikën e Kosovës, me vendimin V_1616_2022, datë 16.11.2022, për subjektin “MFT Energy Kosovo L.L.C”. Ky subjekt ka regjistruar në Republikën e Shqipërisë subjektin “MFT ENERGY KOSOVO”, degë e shoqërisë së huaj.
- Me e-mailin e protokolluar me nr. 610/5 prot., datë 02.05.2024, ERE paraqiti pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovë (ZRRE) kërkesën për informacion në lidhje me vlefshmërinë e kësaj licence dhe në rast se kjo zyrë ka ndërmarrë ndonjë veprim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.
- Në përgjigje, me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 610/6 prot., datë 02.05.2024, ZRRE ka njoftuar se nuk ka filluar dhe as ka ndërmarrë ndonjë vendim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.

- Subjekti ka depozituar në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga neni 4, pika 3 dhe shtojca 1/K e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të rregullores.
- Afati i njohjes së licencës do të jetë i njëjtë me afatin e licencës së lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës, pra deri më datë 15.11.2027.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike, me nr. ZRRE/Li_86/22, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji në Republikën e Kosovës, me vendimin V_1616_2022, datë 16.11.2022, për subjektin “MFT Energy Kosovo L.L.C”, që ka regjistruar në Republikën e Shqipërisë subjektin “MFT ENERGY KOSOVO”, degë e shoqërisë së huaj.
2. Njohja e licencës sipas përcaktimeve të pikës 1 do të jetë e vlefshme deri më datë 15.11.2027.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë dhe Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI